

**AKT- THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“EMIL GROUP”**

**NENI 1**

Ne Durres, sot me date 29.07.2021 ortaket themelues:

**Z. Nunzio Giuseppe Siragusa** i datëlindjes 27.08.1961, lindur ne Prizzi, Itali, me nenshtetesi Italiane, madhor me zotesi te plete juridike për te vepruar me numer karte identiteti AY4382936.

Themelojne shoqerine me pergjegjesi te kuafizuar te emeruar: EMIL GROUP

**Neni 2**

**Selia**

**Durres, Lagja nr.17, rruga Stefan Kaculini, zona kadastrale 8515, Pallati Port View, Kati Dyte.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline, te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithe territorin Shqiptar dhe jashte vendit.

**Neni 3**

**Objekti I veprimtarise**

. Menaxhimi I pasurive te paluajtshme, blerja – shitje, dhenia me qera e pronave te vete kompanise ose te te treteve. Mirembajtje te ambjenteve te veta ose te te treteve.

Pjesmarria ne shoqerise te ndryshme si askioner. Ofrimi i shërbimeve të asistencës dhe konsulencës të shoqërisë, ligjore, kontraktuale, ekonomike, administrative, financiare, biznesore, menaxheriale, dhe të drejtimit për sipërmarrjet, profesionistët, entet private dhe publike, entet lokale dhe të tretët në përgjithësi, me përjashtim kategorik të aktiviteteve profesionale të mbrojtura. Për shembull, tek aktivitetet e sipërcituara futen: përpunimi i të dhënave kontabël,

fiskale dhe financiare për vete dhe të tretë; aktivitete mbështetëse për sipërmarrjet në fazë fillestare (start up) nëpërmjet realizimit dhe menaxhimit të sistemeve të kontabilitetit të përgjithshëm dhe analitike, hartimit të plan bizneseve dhe studimeve të bëshmërisë ekonomikofinanciare që lidhen me projekte investimi; aktivitetet e kontrollit të menaxhimit, planifikimit, organizimit, zhvillimit dhe ristrukturimit të ndërmarrjes; aktivitetet e kërkimit dhe studimit të tregut, me reference të veçantë tek marketingu strategjik; aktivitetet e asistencës dhe konsulencës në fushën e kërkimit të formave të financimit, edhe të lehtësura; aktivitetet e asistencës dhe konsulencës për menaxhimin e logistikës së ndërmarrjes; aktivitetet e asistencës dhe konsulencës në fushën e menaxhimit të prodhimit; aktivitetet 2 e asistencës dhe konsulencës për marrjen e çertifikatave të cilësisë; krijimi dhe menaxhimi i kurseve mbi lëndë teknike dhe/ose tregtare dhe/ose juridike për ndërmarrje e profesionistë, organizimi i kongreseve dhe takimeve në përgjithësi mbi temë të tilla; zhvillimi dhe aplikimi i sistemeve dhe teknikave drejtuese me fokus të veçantë tek analiza dhe planifikimi ekonomik, teknik dhe tregtar; studimi dhe analiza në fushën e kontabilitetit duke ofruar shërbime që kanë të bëjnë ose janë të lidhura me të; konsulencë në fushën e organizimit të ndërmarrjes dhe shërbime me karakter administrativ, kontabël, të shoqërisë, menaxherial, informatik, të punës, të higjenës publike dhe mjedisore, si dhe asistencën që lidhet me to, të menaxhimit të burimeve njerëzore për sipërmarrjet përfshirë kooperativat dhe konsorciumet, entet publike dhe private, shoqatat e kategorisë e vullnetare dhe fondacionet; konsulencë drejtuese në ndihmë të vendimeve strategjike të ndërmarrjeve, konsulencë në realizimin e planeve marketing, konsulencë në realizimin e projekteve të kënaqësisë së konsumatorit, konsulencë në realizimin e një sistemi kontabiliteti të kostove dhe të raportimit të biznesit, konsulencë në lidhje me menaxhimin financier, të menaxhimit të cash-it dhe financës së jashtëzakonshme, planifikim fiskal dhe strategjik ndërkombe tar, konsulencë që lidhet me financimet e lehtësuara dhe mundësitet për sipërmarrjet, aktivitetet e formimit për të punësuarit, administratorët, drejtuesit e sipërmarrësit, konsulencë në menaxhimin e sistemeve të cilësisë për sipërmarrjet dhe në studimet profesionale; aktivitet konsulencë që lidhet me planifikimin ekonomik, tregtar dhe financier të sipërmarrjeve dhe shoqërive, si për ato ashtu dhe për profesionistët; konsulencë në menaxhimin e raporteve ekonomike dhe financiare me të tretë dhe në veçanti me institutet bankare, të kredisë, dhe financiare, si dhe konsulencë, edhe për profesionistët, në planifikimin e strategjive të menaxhimit të profileve financiare dhe ekonomike, edhe nëpërmjet konsulencës në përpunimin e planeve dhe marrëveshjeve; hartim i analizave ekonometrike që lidhen me vlerësimin e kontratave dhe instrumentave bankare si për shembull llogaritë rrjedhëse, kreditë dhe financimet në përgjithësi. Koordinimi teknik, financier, tregtar dhe prodhues i shoqërisë ose enteve në të cilët do të jetë pjesmarrës dhe të cilëve mund t'u ofrojë shërbime, në veçanti por jo ekskluzivisht, administrative, të komercializimit të produkteve, të promovimit të aktivitetit, të publicitetit, të kërkimeve të tregut dhe menaxhimit të 3 burimeve njerëzore, me përashtim të aktivitetave të rezervuara me ligj profesionistëve të regjistruar në regjistra ose lista të veçanta. Studimi, kërkimi, dhe realizimi i produkteve të reja, edhe nëpërmjet realizimit të patentave në fushën industriale, tregtare, shkencore dhe bujqësore.

**Neni : 4**

**Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar I shoqërisë është 100,000 (njeqindmijëlekë), kapitali I shoqerise ndahet ne 1 (nje) kuote.

Kontributet e ortakeve ne kapitalin e shoqerise jane te vleresuara sipas te dhenave te meposhtme:

**Z. Nunzio Giuseppe Siragusa** i datëlindjes 27.08.1961, lindur ne Prizzi, Itali, me nenshtetesi Italiane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar me numer karte identiteti AY4382936.

**Neni 6**

**ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE**

Organet drejtuese te shoqerise do te jene :

Asambleja e per gjithshme e ortakeve eshte I vetmi organ vendimarres I shoqerise.

Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona fizik si administratoret e shoqerise. Afati maksimal I tyre eshte 5 vjet me te drejte riperteritje.

Administratori i emeruar nga Asambleja e per gjithshme e ortakeve eshte:

Z. Setmir Xaxa I lindur me 28.01.1990 ne Durres, me nenshtetesi shqiptare, me numer karte identiteti J00128078M.

**NENI :7**

**Viti Financiar**

Viti Financiar I Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor.

**NENI : 8**


**Dispozita perfundimtare**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise . Ne lidhje me cfaredo aspekti tjeter , qe nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete Akt Themelimmi te shoqerise dhe ne Statutin e saj , zbatohet legjislacioni.ne fuqi per shoqerite tregtare , per QKR-ne si dhe cdo lig jtjete rmbi veprimtarine e shoqerive me pergjegjesi te kufizuar .

Emri dhe nenshkrimi I Ortakeve te Shoqerise

**Ortaku themelues**

**Nunzio Giuseppe Siragusa**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Siragusa Giuseppe Nunzio".